



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:211942

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749572

KPPP.nr.1617/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit G.S.V., me adresë në Fshatin ..., Komuna e Novobërdës, përfaqësuar sipas autorizimit nga Sevdail Robelli, avokat nga Gjilani, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.326/2023 të datës 12.09.2023, të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 29.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas prapësimit të debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.326/2023 të datës 12.09.2023 të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr.1617/23 në çështjen përmbartimore të kreditorit G.S.V., kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje

Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përmbartimore zhvillohet në mes të kreditorit si person fizik dhe debitorit si person juridik, me propozim për përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit në bazë të dokumentit përmbartimor – Aktvendimit me Nr.09/115 të datës 17.12.2019, ndërsa me nenin 13 par.1 nën par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ( Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, dhe nën par. 1.2 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi fizik, ndërsa në cilësinë e debitorit është personi juridik.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5 par 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton se *“ Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbartuese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbartuesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbartimi.”*, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1617/23, datë 29.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.